



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Qershor 2025

DREJTUESIT E DOGANAVE TË BE DHE BALLKANIT PERËNDIMOR RIAFIRMOJNË NË TIRANË ANGAZHIMIN PËR INTEGRIM MË TË THELLË EKONOMIK DHE BASHKËPUNIM NË FUSHËN DOGANORE



Drejtorët e Përgjithshëm të Doganave të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe shtetet anëtare të BE-së u takuan në **12 Qershor** në Tiranë në Konferencën e Dytë të Nivelit të Lartë me temën **“Partneriteti Doganor për një Europë të Lidhur”**. Eventi shërbeu si një platformë kyçe për të përforcuar bashkëpunimin strategjik doganor, për të mbështetur qëllimet e Planit të Rritjes së BE-së dhe për të çuar përpara përafrimin e rajonit me standardet e BE-së.



Konferenca konkludoi me miratimin e një Deklarate të Përbashkët, duke riafirmuar angazhimet e përbashkëta për të përshpejtuar harmonizimin me Kodin Doganor të Unionit, për të zgjeruar dhe institucionalizuar Korsitë e Gjelbra dhe Blu, për të përmirësuar shkëmbimin e të dhënave në kohë reale përmes **SEED+**, për të thelluar bashkëpunimin ndëragjencor dhe të biznesit dhe për të mbështetur hapat drejt njohjes së programeve të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO).

ZHVILLOHET NË TIRANË TAKIMI I 29-TË I NËNKOMITETIT PËR DOGANAT DHE RREGULLAT E ORIGINËS, I KRYESUAR NGA SHQIPËRIA

Në **11 Qershor** Tirana mirëpriti takimin e radhës të Nënkomitetit të CEFTA-s për Doganat dhe Rregullat e Originës, ku përfaqësues të vendeve anëtare diskutuan mbi progresin e arritur në kuadër të prioritetëve të Presidencës së Shqipërisë për vitin 2025 në fushën e bashkëpunimit doganor.

Në qendër të diskutimeve ishin përparimet në menaxhimin e riskut, zbatimi i statusit të **Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO)**, si dhe rregullat e originës, në funksion të rritjes së transparencës dhe lehtësimit të tregtisë brenda CEFTA-s.

Në këtë takim u miratuan Termat e Referencës për krijimin e Trupës Këshillimore për Bashkëpunim Doganor në fushën e Klasifikimit Tarifor dhe Rregullave të Originës dhe të Grupit të Punës për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (AEO), si dhe u finalizua Strategjia për Menaxhimin e Riskut Doganor 2025–2028, bashkë me Planin e Zbatimit dhe Planin e Veprimit përkatës.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE PRITET NË ATHINË NGA DREJTORI I ADMINISTRATËS DOGANORE GREKE

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Doganore Shqiptare, Z. Genti Gazheli u prit në një takim zyrtar në Athinë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Doganore Greke, **Z. Dimitrios Bourikos**. Drejtuesit e Administratave Doganore të Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë gjatë diskutimit theksuan frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe përkushtimit për të rritur marrëdhëniet doganore, promovimin e lehtësimit të tregtisë dhe adresimin e sfidave të përbashkëta të menaxhimit të kufijve.



Gjatë këtij takimi u ra dakord për të zhvilluar më tej iniciativat e koordinuara të menaxhimit të kufirit, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin midis shërbimeve doganore. Gjithashtu, palët pranuan nevojën për të përditësuar marrëveshjet e orarit të punës bazuar në flukset aktuale tregtare, ku u ra dakord për zgjatjen me 2 orë të kohës së operacionit kufitar për kamionët bosh, veçanërisht në pikat kufitare të e **Kakavijës** dhe **Kapshticës**, si dhe për një zgjatje me 1 orë të operacionit kufitar në pikën kufitare të **Qafë Botës**.

DOGANA SHQIPTARE NË MBROJTJE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Administrata Doganore Shqiptare ka pezulluar hyrjen në qarkullim të lirë të disa mallrave që dyshohet se çenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, mes tyre veshje sportive dhe etiketa me marka të njohura, si:

- **1974** kostume sportive “Macron” me mbishkrimin “FSHF”
- **1411** bluza sportive “Macron” me mbishkrimin “FSHF”
- **370** kostume sportive “Adidas” me mbishkrimin “Real Madrid”
- **294** kostume sportive “Nike” me mbishkrimin “Barcelona”
- **11000** etiketa “Lacoste”
- **9000** etiketa “Polo”



Masa është marrë më **22.06.2025** në **Doganën Morinë**, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur tregun dhe konsumatorët nga produktet që shkelin të drejtat e markave të regjistruara.

Dogana Shqiptare mbetet e përkushtuar në garantimin e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale në çdo rast!

DOGANA DIGJITALE



Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Qershor 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **473 shërbime online**.

SEESAC SEMINAR PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR AUTORITETET DOGANORE NË SHQIPËRI

Qendra e Informacionit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Evropën Juglindore (**SEESAC**) organizoi në Tiranë një seminar të specializuar, i cili synon zhvillimin e procedurave standarde të veprimit për autoritetet doganore të Shqipërisë.

Trajnimi kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve të 16 zyrtarëve nga Administrata Doganore, në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të kufijve. Ky seminar përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve në rajon.



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT FALENDERON ADMINISTRATËN DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, z. Armando Duka, ka shprehur mirënjohjen më të sinqertë ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, z. Genti Gazheli, për bashkëpunimin e ngushtë dhe veprimet konkrete në mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale të FSHF-së.

Ky vlerësim vjen pas ndërhyrjes së fundit të Administratës Doganore, më 22 qershor 2025 në pikën doganore Morinë, ku u pezullua hyrja në qarkullim e një sasive të konsiderueshme mallrash që dyshohej se cenonin të drejtat e markave të mbrojtura, përfshirë **1974 kostume sportive** dhe **1411 bluza me emblemen “FSHF”** dhe **markën “Macron”**, si dhe produkte të tjera të markave **“Adidas”, “Nike”, “Lacoste”** dhe **“Polo”**.



BASHKËPUNIM I NGUSHTË SHQIPËRI - TURQI NË FUSHËN DOGANORE

Një delegacion i nivelit të lartë nga Dogana e Turqisë u prit nga drejtuesit e Administratës Doganore Shqiptare në Tiranë, pas takimit të suksesshëm të zhvilluar në Shkurt të këtij viti mes delegacioneve të drejtuesve të administratave doganore në Ankara.

Gjatë takimit përfaqësuesit e dy delegacioneve diskutuan mbi strategjitë e përbashkëta për të luftuar kontrabandën dhe trafikun e paligjshëm, në mënyrë të veçantë për të forcuar bashkëpunimin profesional dhe partneritetin ndërinstitucional në fushën e hetimeve doganore.

Palët ndanë bindjen se, shkëmbimi i praktikave më të mira dhe i informacioneve operative është thelbësor për forcimin e kapaciteteve hetimore dhe për kryerjen e operacioneve të përbashkëta kundër krimeve doganore.

